




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 465 /18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi– Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković, - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë, kundër njoftimit për poentim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës se ish-Kadastrat Prishtinë” me numër të prokurimit: 616-18-4389-2-2-3-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) KK-Prishtinë , më datën 11.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës se ish- Kadastrat Prishtinë” iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK - KK-Prishtinë .

II. ANULOHET, njoftimi për poentim i jurisë profesionale, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës se ish-Kadastrat Prishtinë” dhe lënda kthehet në **Ri vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 18.06.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 30.07.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë me dt: 23.08.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 27.08.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 09.09.2018 me nr. 465 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e ndërtesës së ish-Kadastrat Prishtinë” të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,59,80 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.09.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 04.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit,

konstaton si në vijim:

Autoriteti Kontraktues - KK - Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim, vlerë e mesme konkurs projektim:

Lidhur me pretendimet e OE ankues, ku thotë se AK ka bërë shkelje të LPP-së, konkretisht nenin 7, Barazia në trajtim jo/diskriminim, nenin 59, Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahësimin i Tenderëve, si dhe nenin 80, Përbërja dhe Vendimet e Jurisë.. Ekspertja shqyrtuese - teknike sqaron: Pala me Nr.2609 e konteston vlerësimin e jurisë, për piket maksimale të dhëna kodit nr. 1209 për kundër faktit që ne propozimin e këtij projekti (1209) mungon Koncepti Hapësinor I zgjidhjes. Pra projekti nr.1209, nuk merret fare me trajtimin e objekteve për rreth dhe tërësive tjera urbane, ashtu siç shkruan në këtë kriter vlerësimi. Në pretendimin nr.1 Pala me Nr.2609, ka të drejtë, projekti nr.1209 nuk trajton Konceptin Hapësinor të zgjidhjes (trajtimin e objekteve për rreth dhe të risive tjera urbane) 11. KRITERET VLERSUESE1. Kriteri hapësinor përfshinë:- Konceptin hapësinor të zgjidhjes- Raporti në mes të pjesëve dhe të resisë hapësimore - Vlerat arkitektonike - Kualiteti I hapësirës - Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi Teknik. Ky pretendim është i bazuar

Pala me Nr.2609 konteston vlerësimin e jurisë për piket maksimale të dhëna OE me Nr.1209. Projekti nr.1209 në propozimin e tyre nuk ofrojnë zgjidhjen Open Space, e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për pos kësaj, zgjidhje e tyre është edhe në kundërshtim me standardet dhe parametrat e projektimit. Në këtë pretendim nr.2 Pala me Nr.2609 nuk ka të drejtë, për shkak se në 5. Detyrën Projektuese tek 5.1 Kërkesat Specifikat Dizajnit në piken e 7 thotë: Në pamundësitë e hapjes së tere hapësirës, atëherë aplikuesit udhëzohen të propozojnë organizime alternative. Ky pretendim nuk është mjaftueshëm i bazuar.

Pala me Nr.2609 pretendon se OE(1209) në paragrafin 5/pika 1.2 PARTERI DHE QASJA E NDERTESES, e përshkruan parterin e ngushtëve hyrjes në objekt por jo edhe atë të afërm apo me të gjere, pra nuk merret as me kiosqet as me gjelbërim dhe rregullimin e hapësirës për rreth që është kërkesë kryesore e detyrës projektuese. Në pretendimin nr.3; Pala me Nr.2609 ka të drejtë. se në 5. Detyrën Projektuese tek Ne 5.3 kërkesat tjera / përmbajtja e projektit Pika 5. Zgjidhja urbanistik-arkitektonike e kompleksit me parter, na udhëzon se duhet trajtuar edhe zonën rreth objektit në fjalë. Ky pretendim është i bazuar.

Pala me Nr.2609 pretendon se OE(1209) ,në paragrafin 5- përshkrimi i projekt propozimit, në piken 1.2 parteri dhe qasja në ndërtesë, parasheh 11 parkingje në bërthamat e dy ndërtesave historike, pa bërë analize se si do të ndikoj parkingu në lokacioni dhe në hapësirën e gjelbëruar publikuesi dhe nuk e përfill largimin e parkingjeve e që është kërkesë e detyrës projektuese, Projekti nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrat për ballë shkollës së parë shqipe-me afër rrethit ekzistues. Kjo zhvendosje, jo që nuk ofron zgjidhjen e kërkuar nga komuna, por ngarkon edhe me shumë komunikacionin duke shkaktuar kaos në

rrethin ekzistues dhe degradon objektin fqinje-Shkollën e pare Shqipe ne Prishtine.(shiko 1209, pjesa grafike: Baza Përdheses)

Ne pretendimin nr.4; Pala me Nr. 2609 te drejte. Ne5. Detyrën Projektuese /5.2 Kërkesat Kryesore/Qasja ceket “Për shkak te mungesës se hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër, mundësisht afër zonës historike ne qytet” Ky pretendim është i bazuar

Pala me Nr.2609 pretendon se Projekti nr.1209, I mungojnë detajet qe janë kërkuar ne piken 9 Detajet karakteri stike arkitektonike te Përmbajtjes se projektit. Gjithashtu Projekti nr.1209 nuk ka prezantuar as rrethinat e ndërtesës qe është kërkuar ne piken 10-Perspektiva e ndërtesës me rrethine. Ju mungon kërkesa nr.11 Fotografi – perspektiva te enterierit te propozuar me detaje. Gjithashtu mungon edhe pika 12 e Përmbajtjes se Projektit: Paramasa dhe Paralogarit për implementimin e punëve me specifikimin e materialeve dhe tekniken e punimeve.

Ne pretendimin nr.5 ka te drejte. Ne përmbajtjen e projektit/ Plani I konservimit dhe adaptimit te ndërtesës se Ish Kadastrat te Komunës se Prishtinës duhet te përmbajë: 9. Detajet karakteristike arkitektonike - 10. Perspektiven e ndërtesës me rrethine -11. Fotografi – perspektivat e enterierit te propozuar me detaje- 12. Paramasa dhe paralogarit për implementimin e punëve. Andaj ky pretendim është i bazuar

Pala me Nr.2609 pretendon se Projekti Nr.1209 nuk e arsyeton ekonomikisht e as funksionalisht ndryshimin e vertikaleve te tualeteve duke shkaktuar kosto shtese te pa nevojshme. Shiko vizatimin 04,Baza Katit. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Pala pretendon se Projekti nr.1209 ne paragrafin 5- përshkrimi i projekt propozimit,ne piken 1.2 parteri dhe qasja ne ndërtesë parasheh 11 parkingje ne bërthama te dy ndërtesave historike pa bere analize se si do te ndikoj parkingu ne lokacion dhe ne hapësirën e gjelbëruar publike si dhe nuk e përfill largimin e parkingjeve qe është kërkesë edhe e detyrës projektuese. Projekti Nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrat përball Shkollës se Pare Shqipe dhe ngarkon edhe me shume komunikacionin ne tërësi duke shkaktuar kaos ne rrethin ekzistues.

Ne pretendimin nr.7 Pala ka te drejte. Ne 5. detyrën projektuese /5.2 kërkesat kryesore ceket “Për shkak te mungesës se hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër, mundësisht afër zonës historike ne qytet” Edhe ky pretendim është i bazuar.

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të procesit të prokurimit, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK- KK-Prishtinë, NUK ka respektuar në tersi nenet: 7, 59, 80, të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të amandamentuar, dispozita që kanë të bëjnë me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertët shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE "Hidroing -DK" - Prishtinë, të aprovohet e bazuar (për arsyet që u cekën në pretendimet e lartë shënuar), propozojmë që lënda të kthehet *në Rivlerësim*, dhe të respektohen në tersi dispozitat e LPP-së.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.10.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11.10.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, Eksperti shqyrtues-teknik, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues znj. Morina deklaroj: Pretendimet tona i kemi bere gjate kërkesës në OSHP, qëndroj prapa anekses tone, ekspertet kane sqarua ne ekspertizë, unë e sqaroj piken 2, ne si operator ekonomik e kemi pranuar këtë detyre, ne kemi tentuar gjate procesit. nëse ju referohemi pikës 5.1 kërkesa specifike , nën pika 7 kati i pare te përdoret për zyra administrative për 20 punëtor me mundësi qe 5 punëtor shtesë te përkohshme te kenë mundësi te sistemohen , kurse për pjesët tjera ambienti te jete i hapur, kur kërkesat janë diskutabile për kundër faktit qe hapësirat e hapura, ne prapë vlerësohemi me piken minimale.

Ne raste te tilla ne prokurim kompanitë konceptet e tilla me mangësi janë diskualifikua, pra kërkesa i takon Komunës por me gjitha këto shkelje te ligjit, nuk e di nëse koncept i tillë meriton te vlerësohet tutje.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesi i AK-së z. Sallahu deklaroj: KK-Prishtina ka bërë vlerësimin ne baze te nenit 80 të LPP-së, me ç'rast me datën 27.08.2018 kemi marr vendim ne baze te kërkesë për rishqyrtim, kemi thënë te gjitha sqarimet e shkelura në pretendime , me lejoni te laboroj se komisioni te jete

mos i shfaqur, te mos publikohet, anëtarët e komisionit kanë dhënë vlerësimet, projekti 2607, kryesuesja e komisionit vlerëson se ka vërejtje të organizimit të administratës, trajtimi i materialit, trajtimi i stacionit të autobusëve ,për info pointi thotë se qasje ka vetëm në rrugën x. AK- në baze të pikës 4 pika 80 me qenë se juria nuk ka qenë në baze të komunës, dhe kërkon në fund mendojmë se AK ka respektuar nenin 7,49,68. këtë e ka vlerësuar edhe komisioni i jashtëm

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues teknik znj. Krasniqi deklaroi: OE ka paraqit disa pretendime, në detyrën tenderuese janë paraqit kërkesa që duhet të respektuar sipas rregullave të projektimit, në pretendimin 1 thotë OE- i mungon koncepti hapësinor i zgjedhjes, i cili është i kërkuar sipas tenderit dhe sipas analizës është bërë krahasimi dhe ky ka qenë pretendim të bazuar, pretendimi nr 2. Nuk është pretendim i bazuar, në pamundësi të hapjes së terë hapësirës, mundet të ju pëlqej me shumë sipas hapësirës, Pretendimi nr 3, partneri dhe qasja e ndërtesës përshkruan partnerin e hyrjes në objekt por jo edhe ata të afërm ,pra nuk merret as me gjelbërimin dhe rregullimin e hapësirës që është kërkesë kryesore. Pra pretendim i bazuar.

Pretendimi 6 ankuesi pretendon se OE që ka marrë pike maksimale ka bërë një zgjidhje për vertikale të sanitareve, gjë që rrit edhe koston e renovimit, ky pretendim është pjesërisht i bazuar. sepse në nuk e dimë saktësisht hapësirën e objektit. Pretendimi 7. pretendimi 7 lidhet me pretendimin nr 4. Një zgjidhje që e ka bërë fituesi, ka ofruar parkingun në oborr të trashëgimit kulturor, kurse në detyrën është të jetë diku në qytet.

Në pyetjen e anëtarit të panelit se prej cilës faze të kthehet në rivlerësim sipas jush?

Në përgjigje Eksperti shqyrtues deklaroi: mendoj që ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet prej pikës 0.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroi: Kërkoj që lënda të kthehet në rivlerësim pra në fazën 0 sepse objekti kërkon specifikim me të veçante, vlerësimi i koncepteve të tilla kërkon inxhinier në trashëgimin kulturor.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroi: Lidhur me pretendimin e ekspertit, në kemi cek të gjitha pikat, gjitha këto pretendime kanë qenë të njohura për AK me gjithat projekti me kodin 1209 ka marrë pike maksimale, ndërsa projekti 2607, kërkoj të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues teknik, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Lidhur me pretendimet e OE ankues, ku thotë se AK ka bërë shkelje të LPP-së, konkretisht nenin 7, Barazia në trajtim

jo/diskriminim, nenin 59, Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahësimin i Tenderëve, si dhe nenin 80, Përbërja dhe Vendimet e Jurisë. Paneli shqyrtues duke u bazuar në vlerësimin e Ekspertes shqyrtuese - teknike sqaron: Pala me Nr.2609 e konteston vlerësimin e jurisë, për piket maksimale të dhëna kodit nr. 1209 për kundër faktit që në propozimin e këtij projekti (1209) mungon Koncepti Hapësinor I zgjidhjes. Pra projekti nr.1209, nuk merret fare me trajtimin e objekteve për rreth dhe tërësive tjera urbane, ashtu siç shkruan në këtë kriter vlerësimi. Në pretendimin nr.1 Pala me Nr.2609, ka të drejtë, projekti nr.1209 nuk trajton Konceptin Hapësinor të zgjidhjes (trajtimin e objekteve për rreth dhe tërësive tjera urbane) 11. KRITERET VLERESUESE1. Kriteri hapësinor përfshinë:- Konceptin hapësinor të zgjidhjes- Raporti në mes të pjesëve dhe të resisë hapësinore - Vlerat arkitektonike - Kualiteti I hapësirës - Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi Teknik. Ky pretendim është i bazuar

Lidhur me pretendimin e palës ankuese me Nr.2609 ku konteston vlerësimin e jurisë për piket maksimale të dhëna OE me Nr.1209. Projekti nr.1209 në propozimin e tyre nuk ofrojnë zgjidhjen Open Space, e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për pos kësaj, zgjidhje e tyre është edhe në kundërshtim me standardet dhe parametrat e projektimit. Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit teknik konstaton se në këtë pretendim nr.2 Pala me Nr.2609 nuk ka të drejtë, për shkak se në 5. Detyrën Projektuese tek 5.1 Kërkesat Specifikat Dizajnit në piken e 7 thotë: Në pamundësitë e hapjes së tere hapësirës, atëherë aplikuesit udhëzohen të propozojnë organizime alternative. Ky pretendim nuk është mjaftueshëm i bazuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese me Nr.2609 , ku pretendon se OE(1209) në paragrafin 5/pika 1.2 PARTERI DHE QASJA E NDERTESES, e përshkruan parterin e ngushtëve hyrjes në objekt por jo edhe atë të afërm apo me të gjere, pra nuk merret as me kiosqet as me gjelbërim dhe rregullimin e hapësirës për rreth që është kërkesë kryesore e detyrës projektuese. Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në konstatimet e ekspertit teknike vlerëson se ky pretendim është i qëndrueshëm sepse në 5. Detyrën Projektuese tek Ne 5.3 kërkesat tjera / përmbajtja e projektit Pika 5. Zgjidhja urbanistik-arkitektonike e kompleksit me parter, na udhëzon se duhet trajtuar edhe zonën rreth objektit në fjalë. Andaj ky pretendim është i bazuar.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese me Nr.2609, ku pretendon se OE(1209) ,në paragrafin 5-përshkrimi i projekt propozimit, në piken 1.2 parteri dhe qasja në ndërtesë, parasheh 11 parkingje në bërthamat e dy ndërtesave historike, pa bërë analizë se si do të ndikoj parkingu në lokacionin dhe në hapësirën e gjelbëruar publikuesi dhe nuk e përfill largimin e parkingjeve e që është kërkesë e detyrës projektuese, Projekti nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrat për ballë shkollës së parë shqipe-me afër rrethit ekzistues. Kjo zhvendosje, jo që nuk ofron zgjidhjen e kërkuar nga komuna, por

ngarkon edhe me shume komunikacionin duke shkaktuar kaos ne rrethin ekzistues dhe degradon objektin fqinje-Shkollën e pare Shqipe ne Prishtine.(shiko 1209, pjesa grafike: Baza Përdheses).

Paneli shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e ekspertit teknik konsideron se ne pretendimin nr.4; Pala me Nr. 2609 ka te drejte. Ne5. Detyrën Projektuese /5.2 Kërkesat Kryesore/Qasja ceket “Për shkak te mungesës se hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër, mundësisht afër zonës historike ne qytet” Ky pretendim është i bazuar

Sa i përket pretendimit te palës ankuese me Nr.2609, ku pretendon se Projekti nr.1209, I mungojnë detajet qe janë kërkuar ne piken 9 Detajet karakteristike arkitektonike te Përmbajtjes se projektit. Gjithashtu Projekti nr.1209 nuk ka prezantuar as rrethinat e ndërtesës qe është kërkuar ne piken 10-Perspektiva e ndërtesës me rrethine. Ju mungon kërkesa nr.11 Fotografi – perspektiva te enterierit te propozuar me detaje. Gjithashtu mungon edhe pika 12 e Përmbajtjes se Projektit: Paramasa dhe Paralogarit për implementimin e punëve me specifikimin e materialeve dhe tekniken e punimeve.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e ekspertit teknik konsideron se ne pretendimin nr.5 pala ankuese ka te drejte. Ne përmbajtjen e projektit/ Plani I konservimit dhe adaptimit te ndërtesës se Ish Kadastrat te Komunës se Prishtinës duhet te përmbajë: 9. Detajet karakteristike arkitektonike - 10. Perspektiven e ndërtesës me rrethine -11. Fotografi – perspektivat e enterierit te propozuar me detaje- 12. Paramasa dhe paralogarit për implementimin e punëve. Andaj ky pretendim është i bazuar

Sa i përket pretendimit te palës ankuese me Nr.2609, ku pretendon se Projekti Nr.1209 nuk e arsyeton ekonomikisht e as funksionalisht ndryshimin e vertikaleve te tualeteve duke shkaktuar kosto shtese te pa nevojshme. Shiko vizatimin 04,Baza Katit. Paneli shqyrtues bazuar ne sqarimet e dhëna nga eksperti teknik konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit te palës ankuese se Projekti nr.1209 në paragrafin 5- përshkrimi i projekt propozimit,në piken 1.2 parteri dhe qasja ne ndërtesë parasheh 11 parkingje ne bërthama te dy ndërtesave historike pa bere analize se si do te ndikoj parkingu ne lokacion dhe ne hapësirën e gjelbëruar publike si dhe nuk e përfill largimin e parkingjeve qe është kërkesë edhe e detyrës projektuese. Paneli shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e ekspertit teknik konstaton se Projekti Nr.1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrat përball Shkollës se Pare Shqipe dhe ngarkon edhe me shume komunikacionin ne tërësi duke shkaktuar kaos ne rrethin ekzistues.

Andaj Ne pretendimin nr.7 Pala ka te drejte. Ne 5. detyrën projektuese /5.2 kërkesat kryesore ceket “Për shkak te mungesës se hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër, mundësisht afër zonës historike ne qytet” Edhe ky pretendim është i bazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se ne aktivitetin e prokurimit në fjalë AK- KK-Prishtinë, nuk ka respektuar në tersi nenet: 7, 59, 80, të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të amandamentuar, dispozita që kanë të bëjnë me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit duhet ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – KK-Prishtinë
- 1x1 OE- “Hidroing-DK”shpk-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.